- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: OB614-23-6105-5-2-1/C476

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <u>[gjuha e procedurës - shqipe]</u> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës OI, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzohet tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit me afat të vlefshmërisë prej 150 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.1	Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt. Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre
Programi	12.1	Brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi do të dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me sa vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzimin dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik por jo më shumë se 3 ditë OI duhet të pregaditë Planin dinamik mbrenda suazave të kerkuara si në njoftimin për kontratë neni 11-3 OI duhet të deklarohet me shkrim se do të përmbahet planit dinamik dhe se do ta kryej projektin në afatin e paraparë
Fillimi i punëve	17.1	Kontraktuesi do të fillojë punët brenda 5 dite nga nënshkrimi i kontratës. *Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit.

		Kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të palëve dhe si ditë zyrtare për fillim të punimeve do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 120 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Nëse Ofruesi i punëve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë. Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të harabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim dhe do të jetë përgjegjës për mos futje në penale
Regjistri i punës	20.1	<p>20.1 Një regjistër i punës do të mbahet në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:</p> <p>a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishite, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;</p> <p>b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishite dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.</p> <p>20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij; Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.</p> <p>20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur</p>
Inspektimi dhe testimi	22.1	*Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit

		<p>të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.</p> <p>* Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.</p> <p>Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Organi mbikëqyrës sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testetimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Organi mbikëqyrës nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.</p>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	<p>Periudha garantuese e defekteve është 1095 ditë ose 3 vite</p> <p>Po ashtu për sigurimin e cilësisë së punëve, Operatori Ekonomik pas pranimit teknik duhet të ofrojë garancion bankar për sigurimin e punëve 10 % nga vlera e kontratës, në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do të sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do të sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të faturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Nëse janë grup OE, kjo deklaratë jepet në emër të liderit të konzorciumit</p>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	<p>Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<p>Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës të prokurimit si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Kryesi i shërbimeve.</p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës</p>

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

NDËRTIMI I DY NËNKALIMEVE PËR KËMBËSOR

LOKACIONI: OBILIQ

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

VËREJTJE

Në çmim njësi duhet të parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve para lëshuarjes në punë. Sistemi i materialeve, pastrimi i punishtës nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes së punimeve. Për të gjitha materialet dhe produkte ndërtimore që përdoren, paraprakisht të ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre të çakura edhe në pozicion. Materialet dhe produktet ndërtimore siç janë dhënë në pozicion nuk duhet të ndryshohen apo zëvendësohen pa aprovim nga projektuesi. Në fazën fillestare të përgaditjes së terrenit OE duhet të vendosë të gjithë sinjalizimin rrugor adekuat për siguri në komunikacion si dhe në vendpunishte.

NËNKALIMEVE PËR KËMBËSOR - 1					
A. INFRASTRUKTURA					
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	Punët përgatitore				
1.1	Pregaditja e punishtës duke përfshirë rrethimin dhe të gjitha aktivitetet që mundësojnë fillimin dhe mbarvajtjen e sigurt të punimeve.	Komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
1.2	Piketimi gjedezik I të gjitha elementeve të hapësirës sipas projektit.	Komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
1.3	Pastrimi i hapësirave ku do të ndërtohet nënkalimi si dhe demolimet e nevojshme (materialeve e forta nga betoni dhe materialet tjera) për fillim të punimeve duke përfshirë transportin e tij deri në deponi me distancë max 15km.	m ²	860.00	0.50 €	430.00 €
Shuma 1:					830.00 €
Nr.	Punët e Gërmimit dhe nivelizimit				
2	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km I dheut të kategorisë III dhe IV duke e përfshirë hapësirat e parkut, dhe të gjitha elementet përcjellëse sipas projektit.	m ³	3,280.00	2.00 €	6,560.00 €
2.2	Planiçkimi, ngjeshja dhe kompaktimi i nënbazës pas përfundimit të gërryerjes me Mv>50Mn/m ²	m ²	750.00	0.50 €	375.00 €
2.3	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës brenda mureve ku do të punohen rampa dhe shkallët pra nën pilakën e rampës dhe shkallëve me agregat të thyer fraksion 0/31 dhe 0/62 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Mv>50Mn/m ² . Vërejtje: Mbushja të realizohet pas betonimit të mureve të themeleve perimetrike	m ³	643.20	10.00 €	6,432.00 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe punimi mbushjes nga agregati i thyer guri gëlqeror (0-63 mm), mbrapa mureve vertikale të nënkalimit në perimetër me trashësi 60cm me Mv>60Mn/m ²	m ³	583.40	10.00 €	5,834.00 €
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës nga agregati i thyer guri gëlqeror (0-31.5 mm), shtrirja dhe ngjeshja me Mv>75Mn/m ² nën themele.	m ³	218.65	10.00 €	2,186.50 €
2.6	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës nga agregati i thyer guri gëlqeror (0-63 mm), shtrirja dhe ngjeshja me Mv>60Mn/m ² nën themele.	m ³	326.50	10.00 €	3,265.00 €
Shuma 2:					24,652.50 €
Nr.	Nënkalimi, Rampa & Shkallët				
3	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizimi, transporti dhe kallupimi i betonit të varfër me trashësi (f=10cm me klasë C12/15 si bazë për vendosjen e themeleve të nënkalimit.	m ³	50.00	60.00 €	3,000.00 €
3.2	Furnizimi, transporti dhe kallupimi i betonit të varfër me trashësi (f=8cm me klasë C12/15 si shtresë mbrojtëse e hidroizolimit mbi nënkallimin e këmbësorëve.	m ³	40.00	60.00 €	2,400.00 €
3.3	Furnizimi, transporti, kallupimi, kompaktimi dhe dekalupimi i themelet të nënkalimit nga betoni i klasës C30/37, me aditiv kristalor për arrijtjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos.	m ³	234.15	65.00 €	15,219.75 €



3.4	Furnizimi, transporti, kallupimi, kompaktimi dhe dekalupimi i mureve dhe pllakës horizontale të nënkallimit nga betoni I klasës C35/45N, (betoni duhet të jetë beton I natyralizuar I cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të nënkallimit të jenë të pastërta). Prodhim i betonit të klasës C35/45N sipas EN 1992-1-1. Betoni prodhohet me aditiv për përmirësim të sipërfaqes së betonit të ekspozuar "Mapear Zero" apo I ngjajshëm, si dhe duhet te jete me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Betoni duhet të vihet në vepër në shtresa në lartësi maksimale deri 30 cm dhe të vibrohet në mënyrë kontinuale. Pahitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike. pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.	m ³	196.84	77.00 €	15,156.68 €
3.5	Furnizimi, transporti, kallupimi, kompaktimi dhe dekalupimi i mureve, shkallëve të shkallëve dhe elementeve tjera të shkallëve dhe rampave nga betoni I klasës C35/45N, (betoni duhet të jetë beton I natyralizuar I cili nuk duhet të suvatohet por kallëpet duhen të jenë speciale në mënyrë që faqet e jashtme të nënkallimit të jenë të pastërta). Prodhim i betonit të klasës C35/45N sipas EN 1992-1-1. Betoni prodhohet me aditiv për përmirësim të sipërfaqes së betonit të ekspozuar "Mapear Zero" apo I ngjajshëm, si dhe duhet te jete me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Betoni duhet të vihet në vepër në shtresa në lartësi maksimale deri 30 cm dhe të vibrohet në mënyrë kontinuale. Pahitë për kallëpim të betonit duhet të jenë metalike. pas largimit të pahive, sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet nga papërsosshmëritë nga rrjedhja eventuale e lëngut të betonit ndërmjet pahive.	m ³	268.61	77.00 €	20,682.97 €
3.6	Furnizimi me material, prejja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse, nënkallimit të këmbësorëve, shkallëve dhe rampave me armaturë të brinjëzuar S500.	kg	59,150.00	0.90 €	53,235.00 €
3.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër e gjeotekstilit filtrues 350gr/m ² për mbështjelljen e drenazhës mbrapa murit mbrojtës (mureve ne perimter te nenkalimit).	m ²	1,250.00	1.00 €	1,250.00 €
3.8	Furnizimi dhe instalimi i shtresave për hidroizolim duke përfshirë dy shtresa hidroizoluese nga letër e zallësuar me tyrje në të nxet ne komplet muret ne perimter dhe pllakes mbi nenkalim, siq eshte parapare me projekt. (hidroizolimi duhet të punohet konform prospektit të prodhuesit për llojin përkatës të hidroizollimit).	m ²	1,310.00	8.00 €	10,480.00 €
3.9	Furnizimi dhe instalimi i ujëndalsave nga elastomeri në pikat ku kemi ndërpreje të betonimit. (min 32cm në dy anë).	m'	38.00	22.00 €	836.00 €
3.10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e parrmakëve në anash shkallëve. Parnakët përbëhen nga një gyp çeliku F75mm te galvanizuar I fiksuar në çdo 1.5m në murin vertikal, të lyer me dy shtresa ngjyrë dhe parangjyrë (sipas detaleve në projekt).	m'	64.00	30.00 €	1,920.00 €
3.11	Furnizimi, transporti dhe vendosja e parrmakëve në dy anët e rampave. Parnakët përbëhen nga një gyp çeliku F75mm te galvanizuar I fiksuar në muri në çdo 1.5m, të lyer me dy shtresa ngjyrë dhe parangjyrë (sipas detaleve në projekt).	m'	128.00	30.00 €	3,840.00 €
3.12	Furnizimi, transporti dhe vendosja e parrmakëve të këmbësorëve. Parnaku përbëhen nga dy gypa paralel vertikale të fiksuar në beton në çdo 1.50 me profil f75mm, mbushje vertikale f22mm në çdo 11.0cm. Të gjitha pozicionet duhen të lyen me dy shtresa ngjyrë dhe parangjyrë (sipas detaleve në projekt).	m'	182.00	30.00 €	5,460.00 €



3.13	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave nga graniti natyral me trashësi t=2.0cm të vendosura në hapsirën për qarkullim të nënkalkimit, rampave dhe mveshja e shkëlqeve dhe pjesës vertikale të shkallëve. (Forma, lloji dhe dimensionet e pllakave sipas detaleve në projekt. Ngjitja me lëpak për pllaka të ambienteve të jashtme).	m ²	567.18	50.00 €	28 359.00 €
				Shuma:3	161,839.40 €
Nr. Kubëzat e betonit					
4	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
4.1	Furnizimi me material dhe kufizimi i shtigjeve rreth objektit dhe platove para hyrjeve kryesore me gurë skajorë nga betoni i presuar me vibrim, me dimensione 8x20x100 cm dhe ngjyrë natyrale të betonit duke përfshirë edhe punimin e bazamentit me beton. Gurët skajor duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të kripërave për shkrijen e akujve të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338 2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m'	124.80	9.00 €	1 123.20 €
4.2	Furnizimi me material dhe shtrimi i shtigjeve rreth nenkalimit dhe casjes në të me kubëza nga betoni i presuar me vibrim, tipi BEHATON, me dimensione 20x16 cm dhe trashësi t=8 cm, me sipërfaqe të parrëshqitshme, me dizajn të kombinuar me kubëza me ngjyrë natyrale të betonit dhe ngjyrë tjetër opcionale. Në çmim duhet të përfshihet: 1. Ngjeshja me makineri deri në arritjen e kompaktësisë Ms=80MPa 2. Shtresa e zhavorit 0-60 mm me trashësi 20 cm, 3. Shtresa e zhavorit 0-31 mm me trashësi 10 cm 4. Shtresa e zhavorit 4 - 8 mm me trashësi 5 cm dhe 5. Finalizimi me mbushjen e fugave. Kubëzat duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, rezistenca në fërkim dhe gërryerje, qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të kripërave për shkrijen e akujve, të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338.2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.	m ²	296.45	14.00 €	4 150.30 €
				Shuma:4	5,273.50 €
Nr. Punë e tjera					
4	Përshkrimi i punëve. Në përputhshmëri të plote me standardet EC dhe ISO.	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
4.1	Prerja, gryerja, demolimi dhe largimi i materialit deri në deponi të asfaltit ekzistues të rruges duke përfshirë skajoret e rruges dhe trotuarit dhe kubëzat, materiali i gërmuar duhet të transportohet deri në deponi 5km sipas menaxherit të kontratës.	m ²	98.00	3.50 €	343.00 €
	Germimi i shtresës së humusit, prerja e shkurreve dhe pastrimi i terrenit ku do të punohet rruga e perkoshme (bypass).	m ²	175.00	2.40 €	420.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-63 dhe 0-31.5mm) për trasimin e rruges që do përdoret si BYPASS gjatë kohës së punimeve. Zhavori duhet të shtrihet në komplet sipërfaqen e planifikuar në shtresa, çdo shtresë duhet të ujitet, për të bërë materialin kompakt. Ngjeshja duhet të arrijë koficientin 40 MN/m ² .	m ³	64.85	12.00 €	778.20 €



4.3	<p>Furnizimi, transporti dhe vendosja Asfaltit (Bito Zhavor) me fraksion të agregatit Ø 0-16mm, me trashësi t= 8 cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në mënyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hudhjes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kërkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës sa duhet të jetë cilindri në mesë Finisherit të Asfaltit.</p> <p>Në çmim duhet të përfshihet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngjeshja me makineri deri në arritjen e kompaktësisë Ms=60MPa 2. Gjcootekstil (300g/m2), 3. Shtresa e zhavorit 0-60 mm me trashësi 20 cm 4. Shtresa e zhavorit 0-31 mm me trashësi 10 cm dhe 5. Asfalti t=8cm <p>Kubëzat duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, rezistenca në fërkim dhe qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.</p>	m ²	75.00	20.00 €	1,500.00 €
4.4	<p>Furnizimi me material dhe shtrimi i shtigjeve të trotuarit të larguar gjatë punimeve tek rruga me kubëza nga betoni i presuar me vibrim, tipi BEHATON, me dimensione 20x16 cm dhe trashësi t=8 cm, me sipërfaqe të parrëshqitshme, me dizajn të kombinuar me kubëza me ngjyrë natyrale të betonit dhe ngjyrë tjetër opcionale.</p> <p>Në çmim duhet të përfshihet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngjeshja me makineri deri në arritjen e kompaktësisë Ms=80MPa 2. Shtresa e zhavorit 0-60 mm me trashësi 20 cm, 3. Shtresa e zhavorit 0-31 mm me trashësi 10 cm 4. Shtresa e zhavorit 4 - 8 mm me trashësi 5 cm dhe 5. Finalizimi me mbushjen e fugave. <p>Kubëzat duhet të plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë ndaj ngricave, rezistencës ndaj shtypjes dhe lakimit, rezistenca në fërkim dhe qëndrueshmërinë ndaj ndikimit të kripërave për shkrirjen e akujve të kenë stabilitet forme dhe të dimensioneve, të mos thithin ujin dhe veti tjera sipas standardit BS EN 1338:2000 në lidhje me elementet nga betoni i ngjeshur.</p>	m ²	22.50	20.00 €	450.00 €
Shuma 4					3,491.20 €
C INFRASTRUKTURA					
1	Punët përgatitore				830.00 €
2	Punët e Gërmimit dhe nivelizimit				24,652.50 €
3	Nënkalmi, Rampa & Shkallët				161,839.40 €
4	Kubëzat e betonit				5,273.50 €
5	Punë e tjera				3,491.20 €
TOTALI					196,086.60 €
B HIDROINSTALIMET					
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	PUNIMET E KANALIZIMIT ATMOSFERIK - NENKALIMET				



1.1	Gërmimi i dheut për hapjen e kanalit dhe pusëtave, nivelimi i kanalit pas gërmimit, mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar me ngjeshja në çdo 30cm, gërmimi të behet me thellësi sipas terrenit për ramje të gravitetit. Në çmimi të llogaritet vendosja e pahive siguroese kur kanali kalon thellësinë 140cm, matjet gjeodezike/ nivelet sipas terrenit ekzistues dhe të gjitha punët e nevojshëm për këtë pozicion. Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar të lartësisë së mbetur në shtresa prej 30cm me ngjeshje përkatëse. Dheu i tepërt të barte në dopninë e parapare nga investitori. Llogarite në metër kub.	m ³	80.00	1.80	144.00 €
1.2	Furnizimi, vendosja dhe planifikimi i rërës mbi dhe nën gyp në trashësi 15 cm, mbi gypin dhe rreth gypit t=20cm. Llogaritet në metër kub.	m ³	20.00	9.00	180.00 €
	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i pusëtave me elemente të gatshme Ø800mm nga betoni MB-40, pjesa konike e pusëtës të përforcohet me beton. Në çmim të llogariten pjesët konike si dhe punimi i kinetës me beton (sipas detalit në projekt), kapaku dhe unaza nga materiali Kompozit B125 me aftësi mbajtëse Q=60T dhe të gjitha punë e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në cope. Thellessia sipas projektit	copë	5.00	60.00	300.00 €
	Furnizimi, transporti i dhe punimi i konusav të parafabrikua nga betoni MB-40 me diamter Ø800/600mm.	copë	5.00	40.00	200.00 €
	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i grilave ujëmbledhëse me elemente të gatshme. Në çmim të llogariten pjesët konike si dhe punimi i kinetës me beton me ramje të caktuar, kapaku Grilë (dim. 20x20cm) nga materiali Kompozit B125 dhe të gjitha punë e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në cope.	m ²	18.00	25.00	450.00 €
	Testimi i rrjetit para dhe pas mbulimit të kanalit	komplet	1.00	50.00	50.00 €
	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave nga HDPE-ja të brinjëzuar SN8. Në çmim të llogaritet edhe fazoneria komplet dhe të gjitha punë e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në meter gjatësi.				
1.4	Ø200mm	m ¹	150.00	5.50	825.00 €
1.5	Ø160mm	m ¹	50.00	3.70	185.00 €
1.6	Ø125mm	m ¹	50.00	3.00	150.00 €
1.7	Kthesa Ø125mm. <45° Geberit apo të ngjashum	copë	14.00	2.50	35.00 €
1.8	Furnizimi dhe montimi i pompës me presion Q=5 L/s, H=20m; Pel=1.5 KW me kualitet sipas ISO 9001. Në çmimi të llogaritet boca, paneli komandues dhe të gjitha punë e nevojshëm për këtë pozicion. Të përfshihet edhe kyqja dhe instalimi i pompes. Llogaritet në cope.	copë	1.00	400.00	400.00 €
				Shuma1:	2,919.00 €
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
2	PUNIMET E KANALIZIMIT ATMOSFERIK - SHKARKIMI				
2.1	Gërmimi i dheut për hapjen e kanalit dhe pusëtave, nivelimi i kanalit pas gërmimit, mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar me ngjeshja në çdo 30cm, gërmimi të behet me thellësi sipas terrenit për ramje të gravitetit. Në çmimi të llogaritet vendosja e pahive siguroese kur kanali kalon thellësinë 140cm, matjet gjeodezike/ nivelet sipas terrenit ekzistues dhe të gjitha punët e nevojshëm për këtë pozicion. Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar të lartësisë së mbetur në shtresa prej 30cm me ngjeshje përkatëse. Dheu i tepërt të barte në dopninë e parapare nga investitori. Llogarite në metër kub.	m ³	400.00	1.80	720.00 €



2.2	Furnizimi, vendosja dhe planifikimi i rërës mbi dhe nën gyp në trashësi 15 cm, mbi gypin dhe rreth gypit $t=20\text{cm}$. Llogaritet në metër kub.	m^3	110.00	9.00	990.00 €
2.3	Furnizimi me material dhe mbushja e pjesës mbi kanalit me agregat të zhyer fraksion 0/31 dhe 0/62 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijjen e kompaktësisë $M_v > 50\text{MN/m}^2$. Në çmim të përfshihet shtruarja e gjeotekstilit (300g/m ²) dhe shtruarja në tërësi edhe vendosja Asfaltit (Bito Zhavor) me fraksion të agregatit $\varnothing 0-16\text{mm}$, me trashësi $t=8\text{cm}$. Vërejtje: Të kthehet gjendja e rrugëve në gjendjen e mëparshme.	m^2	60.00	14.00 €	840.00 €
2.3	Prerja, grryerja, demolimi dhe largimi i materialit deri në deponi të asfaltit ekzistues të rrugës duke përfshirë skajoret e rrugës dhe trotuarit dhe kubezat, materiali i gërmuar duhet të transportohet deri në deponi 5km sipas menaxherit të kontratës.	m^2	60.00	4.00 €	240.00 €
	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave nga HDPE-ja të brinjëzuar SN8. Në çmim të llogaritet edhe fazoneria komplek dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në metër gjatësi.				
2.4	$\varnothing 400\text{mm}$	m	320.00	14.00	4,480.00 €
2.5	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i pusetave $\varnothing 1000\text{mm}$ me elemente të gatshme nga betoni MB-40, pjesa konike e pusetës të përfordhet me beton. Në çmim të llogariten pjesët konike si dhe punimi i kinezës me beton, shkallet metalike $\varnothing 22\text{mm}$, kapaku dhe unaza nga materiali Kompozit B125 me aftësi mbajtëse $Q=60\text{T}$ dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në cope. Thelksia pusetas sipas projektit.	copë	10.00	50.00	500.00 €
2.6	Furnizimi, transporti i dhe punimi i konusave të parafabrikuar nga betoni MB-40 me diamter $\varnothing 1000/600\text{mm}$.	copë	10.00	40.00	400.00 €
Shuma1:					8,170.00 €
Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
3	PUNIMET E DRENAZHIMIT				
3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rërës $h=15\text{cm}$ në fund të kanalit mbi të cilën shtrihen gypat e drenazhës.	m^3	20.00	9.00 €	180.00 €
3.2	Furnizimi, mbushja dhe vendosja e zhavorrit lumit me granulometrë 1-5cm. Vendoset në thasë rrjete në tërësi perimetrit e objektit.	m^3	140.00	7.00 €	980.00 €
	Furnizimi, transporti dhe punimi i rrjetit Drenazhës me gypa të brinjëzuar dhe perforuar (HDPE) sipas projektit. Në çmim të llogariten të gjitha elementet e nevojshme për montim dhe kompleumin e këtij pozicioni. Llogarite në metër gjatësi.				
3.3	$\varnothing 200\text{mm}$	m	126.00	4.50 €	567.00 €
3.4	Furnizimi, transporti, montimi dhe punimi i pusetave $\varnothing 1000\text{mm}$ me elemente të gatshme nga betoni MB-40, pjesa konike e pusetës të përfordhet me beton. Në çmim të llogariten pjesët konike si dhe punimi i kinezës me beton, shkallet metalike $\varnothing 22\text{mm}$, kapaku dhe unaza nga materiali Kompozit B125 me aftësi mbajtëse $Q=60\text{T}$ dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogarite në cope. Thelksia sipas projektit.	copë	20.00	50.00 €	1,000.00 €
3.5	Furnizimi, transporti i dhe punimi i konusave të parafabrikuar nga betoni MB-40 me diamter $\varnothing 1000/600\text{mm}$.	copë	2.00	40.00 €	80.00 €
Shuma1:					2,807.00 €
HIDROINSTALIMET					
C					
1	PUNIMET E KANALIZIMIT ATMOSFERIK - NENKALIMET				2,919.00 €
2	PUNIMET E KANALIZIMIT ATMOSFERIK - SHKARKIMI				8,170.00 €



3	PUNIMET E DRENAZHIMIT				2,807.00 €
				TOTALI	13,896.00 €
C ELEKTROINSTALIMET					
Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	PUNET NDERTIMORE PËR KANALIZIMIN KABLËOR				
1.1	Mihja dhe mbyllja e kanalit me dimensione: 80x40cm, per shtrirjen e kabllos dhe kthimi i tij në gjendjen e mëparshme. Në çmim përfshihet deponimi i dheut të gërmuar si dhe kthimi i tij prap në kanal dhe ngjeshja e tij.	m	60.00	1.80	108.00 €
1.2	Furnizimi dhe shtrirja e rërës fraksion 0-30mm për mbrojtjen e gypave në kanal, rëra shtrihet nën gypa 10 cm dhe mbi gypat 10cm. Dim: (0.8x0.22) x1500m	m ²	5.50	10.00	55.00 €
1.3	Furnizimi dhe vendosja e shiifti per paralajmrim "rrezike per jete"	m	60.00	1.00	60.00 €
1.4	Furnizimi dhe vendosja e gypit te brinjzuar dyshtresor Ø63mm se bashku me vazhduese kthesa dhe elementet tjera percjellese.	m	65.00	1.50	97.50 €
1.5	Furnizimi dhe montimi i kanalit metalik PNK me dimensione 100x50mm nga elementet e zinkuara për shtatje të kabllove të tensionut , të përfshihen edhe elementet lidhese dhe mbajtëse dhe përforcuese.	m	65.00	7.00	455.00 €
1.6	Furnizimi dhe montimi i mbajtësit profil L, L=10cm i cili duhet te ankerohet ne beton.	copë	35.00	7.00	245.00 €
1.7	Furnizimi dhe montimi i ktheses L 100mm	copë	3.00	4.00	12.00 €
1.8	Furnizimi dhe montimi i pusetave prej blastike me dimensione 300x300x320 si detalin e pusetes.	copë	1.00	60.00	60.00 €
1.9	Furnizimi dhe montimi i Orman plastike 100x100x100 mm, IP67, CP5003D	copë	1.00	40.00	40.00 €
2.0	Punet e pascifikuar(bartja e dheut, mbulimi i kanalit ngjeshja)	pl	1.00	50.00	50.00 €
				Shuma1:	1,182.50 €

Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
2	SHPERNDARJA KABLORE PER NDRICIMIN ELEKTRIKE				
2.1	Furnizimi dhe instalimi i kabllove energjetike NYJ-J 5x2.5mm ² (Për ndricimin dhe pompen)	m	138.00	1.90 €	262.20 €
2.2	Furnizimi dhe instalimi i kabllove energjetike N2XH-J 5x1.5mm ²	m	64.00	0.95 €	60.80 €
				Shuma1:	323.00 €

Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
3	TRUPAT NDRICUES LED DHE SHTYLLAT METALIKE				
3.1	Furnizimi dhe montimi i trupit ndricues Pelsan 111273 Etna G2 apo i ngjshem, Led ne forme lineare 100W, per montim ne plafon prej betoni apo kanal metalik. Operim 50,000 hrs, AC 220-240V, 50/60Hz, 133 lm/W, 4500K, 13300 lm, CRI>80, Power Faktor >0.95, Temperatura e operimit -20°C / 45°C, IP65, Dimenzione 590x86x178. me 5 vite garancion.	copë	8.00	75.00 €	600.00 €
				Shuma1:	600.00 €

Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
4	TABELA ENERGETIKE				



4.1	Furnizimi dhe montimi i tabelës së ndricimit të jashtëm KSHE me dimensione 105x80x30cm, IP65, propozohet CDCP, ABB, tabela duhet të jetë metalike e galvanizuar, siç është përshkruar në përshkrim teknik. Ormani duhet të ketë skemën njëpolshe të vendosur brenda, numrin e ormanit si dhe shenjën e rrezikut të vendosur jashtë. Karakteristikat teknike: Enclosure series CDC and SDC are made of galvanized steel sheet and with the performance standards ISO 1461, IEC 61439-1, IEC 61439-5.	copë	1.00	270.00 €	270.00 €
4.2	Përgaditja e bazamentit prej betoni për vëndosjen e Ormanave kryesor me gypave të brinjëzuar+armatur dhe beton të klases C-25/30 me dimensione (155x80x30)cm, sipas detajit në projekt. Në qmim përfshihet hapja e themelit të bazamenteve dhe largimi i dheut deri në deponi dhe mbushje të hapësirës rreth bazamentit.	copë	1.00	85.00 €	85.00 €
4.3	Montimi i njëjësorëve tre fazor 100A, 220/380, dy tarifor (njehsonn.e.sjell KEDS-i).	copë	1.00	75.00 €	75.00 €
4.4	Furnizimi dhe montimi i Mbrojtjes diferenciale RCCB katërpolare me rryma nominale In=32A dhe rryma diferenciale Idn=0.3A	copë	1.00	30.00 €	30.00 €
4.5	Furnizimi dhe montimi i sigureses automatike 3P me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=20A dhe 3p, Icc=6kA.	copë	1.00	25.00 €	25.00 €
4.6	Furnizimi dhe montimi i sigureses automatike 3P me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=16A dhe 3p, Icc=6kA. Per pompen	copë	1.00	17.00 €	17.00 €
4.7	Furnizimi dhe montimi i sigureses automatike 1P me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=10A.	copë	1.00	2.20 €	2.20 €
	Furnizimi dhe montimi i sigureses automatike 1P me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=6A.	copë	3.00	2.20 €	6.60 €
	Furnizimi dhe montimi i ndërperersit (1,0,2) 3p, 16A.	copë	1.00	12.00 €	12.00 €
	Furnizimi dhe montimi i Fotoqelis se bashku me relen	copë	1.00	14.00 €	14.00 €
	Kontaktör modular, 3Polar, 25A, 230V	copë	1.00	23.00 €	23.00 €
4.8	Furnizimi dhe montimi i klemëve shpërndarese amocanali 80A	copë	4.00	22.00 €	88.00 €
4.9	Materiali i imët lidhës i pa specifikuar (mihja e kanalit për tabelën energjetike bartja e dheut ose mbushje të hapësirës).	pl	1.00	60.00 €	60.00 €
Shuma1:					707.80 €

Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
5	TRUPAT NDRICUES LED DHE SHTYLLAT METALIKE				
5.1	Network IR outdoor vandal bullet camera, 5MP @30fps, 2.8mm fixed lens (104.7°), triple codec H.265/H.264/MJPEG with WiseStream II, Multiple streaming, 120dB WDR, Auto Day & Night (ICR), IR viewable length 20m, Advanced Video Analytics, Hallway View, Motion detection LDC (Lens Distortion Correction), Bi-directional audio and SD/SDHC/SDXC slot, CVBS for easy installation, IP66, IK10, PoE, QNO-8010R Apo të ngjajshme	cope	2.00	250.00 €	500.00 €
	4CH Network Video Recorder with PoE Switch, Up to 4CH 12megapixel supported, H.265, H.264, MJPEG codec supported, H.265, H.264, MJPEG codec supported, 180Mbps network camera recording, Plug & play by 16 PoE/PoE+ ports, Max. 4HDDs, e-SATA storage supported, HDMI / VGA local monitor, XRN-1610S	cope	1.00	200.00 €	200.00 €
	Media converter Fiber to LAN 20Km 10/100/1000	cope	2.00	45.00 €	90.00 €
	6 port switch, with 4 PoE ports 10/100Mbps	cope	1.00	55.00 €	55.00 €
	Orman plastik i zbrazët 300x400x165mm, komplet me siguresa, priza elektrike të mjaftueshme, CP5003D	cope	1.00	45.00 €	45.00 €

	8-Port Gigabit Easy Smart Switch	cope	1.00	55.00 €	55.00 €
	Splajsimi i fibres	pl	1.00	130.00 €	130.00 €
	Tub nga HDPE fi 50 / Elektrik	meter	120.00	0.40 €	48.00 €
	Utp Cat 6e, outdoor	meter	120.00	0.50 €	60.00 €
	Kablllo optike SM mode 12 fibre lidhet me sistemin egzistues të kamerave tek rrethi ne shtyllen e ndricimit	meter	180.00	1.00 €	180.00 €
	Kablllo e rrymes 3x1.5	meter	38.00	0.70 €	26.60 €
	Konektor, konektor te fibres mbajtesa te kamerave, elj	pl	1.00	80.00 €	80.00 €
	Furnizimi dhe montimi i Directional dual-band antenna for UAP-AC-M (Lidhet/komunikon me antenen e nenkalimit 2)	cope	1.00	220.00 €	220.00 €
	Instalimi i sistemit, konfigurimi	pl	1.00	280.00 €	280.00 €
				Shuma1:	1,969.60 €

C		ELEKTROINSTALIMET		
1	PUNËT NDËRTIMORE PËR KANALIZIMIN KABLLOR			1,182.50 €
2	SHPERNDARJA KABLLORE PER NDRICIMIN ELEKTRIKE			323.00 €
3	TRUPAT NDRICUES LED DHE SHTYLLAT METALIKE			600.00 €
4	TABELA ENERGJETIKE			707.80 €
4	TRUPAT NDRICUES LED DHE SHTYLLAT METALIKE			1,969.60 €
			TOTALI	4,782.90 €

Rekapitulimi:		
NDËRTIMI I DY NËNKALIMEVE PËR KËMBËSOR		NËNKALIMEVE PËR KËMBËSOR - 1
A	INFRASTRUKTURA	196,086.60 €
B	HIDROINSTALIMET	13,896.00 €
C	ELEKTROINSTALIMET	4,782.90 €
TOTALI		214,765.50 €

NËNKALIMEVE PËR KËMBËSOR - 2					
A INFRASTRUKTURA					
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	Punët përgatitore				
1.1	Pregaditja e punishtës duke përfshirë rrethimin dhe të gjitha aktivitetet që mundësojnë fillimin dhe mbarvajtjen e sigurt të punimeve.	Komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
1.2	Piketimi gjedezik i të gjitha elementeve të hapësirës sipas projektit.	Komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
